

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
AGROCON ALBANIA SH.P.K
RRUGA "QENDËR", NDËRTESE PRIVATE, ZK 2790, NR.PASURIE 153, FSHATI "NGURRËS I
VOGËL", KRUTJE, FIER
REGJISTRUAR PRANË REGJISTRIT TREGTAR ME NUMËR IDENTIFIKIMI
L324060240

VENDIM NR. 9

I

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më 12.12.2019, në orën 10.00, në selinë e Shoqërisë **AGROCON ALBANIA Sh.p.k.** (më tej referuar si "Shoqëria"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

Është e pranishme shoqëria "**UNITED ELECTRONIC DISTRIBUTION FZE**, një shoqëri e themeluar ne përputhje me ligjet e Dubai dhe rregullave dhe rregulloreve te Zonës se Lire Tregtare Jebel Ali, me seli ligjore ne JAFZA 15, Office 15-236, Jebel Ali Free Zone, Dubai, Emiratet e Bashkuara Arabe, me Numër Regjistrimi nr. 162667, (më tej referuar si "**Ortaku i Vetëm**") rregullisht e përfaqësuar nga Z. Altin Daka, shtetas shqiptar, lindur më 16.03.1972, në Durrës, Shqipëri, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës shqiptare me nr. BI4196267, rezident ne Dubai, Emiratet e Bashkuara Arabe, mbajtës i lejes se qëndrimit nr. 087355724, e cila zotëron 100% të kapitalit të Shoqërisë.

Kryetari i Asamblesë, Z. Daka pasi deklaroi vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaroi Asamblesën e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit n. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

REND DITE

- I. MIRATIMI I ZMADHIMIT TE KAPITALIT NËPËRMJET KAPITALIZMIT TE PJESSHEM TE HUASE TE ORTAKUT TE VETËM.**
- II. PRANIMIN E DORËHEQJES SE ADMINISTRATORIT Z. FLORIAN LAMA.**
- III. EMËRIMIN NE DETYRËN E ADMINISTRONIT ZNJ. BLERINA DAKA.**
- IV. TË NDRYSHME.**

Kryetari i Asamblesë, në lidhje me pikat e mësipërme të rendit të ditës, parashtron sa më poshtë.

- I. MIRATIMI I ZMADHIMIT TE KAPITALIT NËPËRMJET KAPITALIZMIT TE PJESSHËM TE HUASE.**

Në lidhje me pikën e parë, Kryetari i Asamblesë parashtrohet se Ortaku i Vetëm, Shoqëria **UNITED ELECTRONIC DISTRIBUTION FZE** vlerëson me përparësi qe, shuma prej 2.530.000 Euro (dy milion e pesëqind e tridhjetë mijë euro) detyrim i Agrocon Albania kundrejt Ortakut të Vetëm, e cila buron si rezultat i lidhjes ndërmjet palëve të Kontratës për Kalimin e Pjesshëm të Debitit të datës 01.11.2019, sipas së cilës Agrocon Albania Sh.p.k ka ceduar tek Ortaku i Vetëm detyrimin e pjesshëm të saj kundrejt ish ortakut Balfin Sh.p.k., sipas Marrëveshjes së Financimit të datës 30.06.2017, e ndryshuar.

Konkretisht, Kryetari sqaron se shuma me të cilën do të zmadhohet kapitali aktual i Shoqërisë është shuma e ceduar 2.530.000 Euro (dy milion e pesëqind e tridhjetë mijë euro) i barasvlershmen me kundërvlerën **311,670,700 Leke (treqind e njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind leke)**, sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të datës 01.11.2019 i barabartë me 1 Euro = 123.19 Leke.

Për rrjedhim të sa me sipër propozohet që kapitali i Shoqërisë aktualisht në vlerën 356,279,234 Lek (treqind e pesëdhjetë e gjashtë milion e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e tridhjetë e katër leke) të zmadhohet 311,670,700 Leke (treqind e njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind leke), për një kapital në një vlerë totale prej **667,949,934 Lek (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër leke)**.

II. MIRATIMIN E DORËHEQJES SË PARAQITUR NGA ADMINISTRATORI I SHOQËRISË Z. FLORIAN LAMA

Në lidhje me pikën e dytë të Rendit të Ditës, parashtrohet se, meqenëse z. Florian Lama ka paraqitur dorëheqjen nga detyra me anë të "Kërkesës për Dorëheqje", në të cilën ai shpreh pamundësinë e tij objektive për vijimin e ushtrimit të funksioneve të administratorit të Shoqërisë për arsye personale, të cilat e detyrojnë atë të kërkojë dorëheqjen nga detyra, duke shprehur disponibilitetin e tij për të bërë dorëzimet e nevojshme dhe për të qëndruar në detyrë deri në momentin e emërimit të administratorit të ri. Në kushtet kur nga ana e z. Florian Lama na është njoftuar pamundësia për vazhdimin e ushtrimit të funksioneve të administratorit, duke dhënë edhe argumentet përkatëse në lidhje me këtë pamundësi mendojmë se është e arsyeshme që kërkesa e tij të pranohet, duke kërkuar ushtrimin e funksioneve deri në momentin e dorëzimit të detyrës administratorit të ri.

III. MIRATIMI I ADMINISTRATORIT TË RI TË SHOQËRISË ZNJ. BLERINA DAKA

Në lidhje me pikën e tretë në Rendit të Ditës, Kryetari parashtrohet se, miratimi i dorëheqjes së z. Florian Lama, nga detyra e administratorit të shoqërisë është shoqëruar me paraqitjen e një kandidature të re për kryerjen e kësaj detyre.

Znj. Blerina Daka, shtetase shqiptare, lindur më 31.03.1975, në Tiranë dhe banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 030885829, dhe me numër personal H55331143Q, në detyrën e administratorit të shoqërisë "Agrocon Albania" SHPK, ka një jetëshkrim të përshtatshëm për ushtrimin e funksioneve, një eksperiencë disa vjeçare në menaxhim dhe integritet të lartë moral. Si e

tillë vlerësojmë këtë kandidaturë të përshtatshme për të ushtruar detyrën e administratorit të shoqërisë.

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Ortaku i Vetëm

VENDOSI:

- A. Të miratojë zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë nëpërmjet kapitalizimit të vlerës së pjeshme të pashlyer të Huas së dhëne nga Balfin Sh.p.k., në favor të Agrocon Albania Sh.p.k., sipas Marrëveshjes së Financimit date 30.06.2017 (të ndryshuar) dhe të ceduar tek Ortaku i Vetëm sipas Kontratës për Kalimin e Pjeshtë të Debitit date 01.11.2019 në shumën 2.530.000 Euro (dy milion e pesëqind e tridhjetë mijë euro) e llogaritur në kundërvlerën në leke në shumën **311,670,700 Leke (treqind e njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind leke) ("Zmadhimi i Kapitalit")**.
- B. Bazuar në sa më sipër Zmadhimi i Kapitalit do të konsiderohet i shlyer plotësisht nga Ortaku i Vetëm.
- C. Si rezultat i miratimit të Zmadhimit të Kapitalit sipas pikave (A) dhe (B) më sipër, Kapitali i Shoqërisë, nga 356,279,234 Lek (treqind e pesëdhjetë e gjashtë milion e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e tridhjetë e katër leke) do të bëhet në shumën **667,949,934 Leke (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër leke)**.
- D. Të miratojë dorëheqjen e z. Florian Lama nga detyra e administratorit, që nga data 11.12.2019.
- E. Të miratojë emërimin e Znj. Blerina Daka, shtetase shqiptare, lindur më 31.03.1975, në Tiranë dhe banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 030885829, dhe me numër personal H55331143Q, në detyrën e administratorit të shoqërisë "Agrocon Albania" SHPK, për një afat 1 (një) vjeçar, i cili fillon efektet nga data 12/12/2019 dhe i përfundon më datë 12/12/2020;
- F. Autorizohet Znj. Blerina Daka në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë që, duke vepruar personalisht ose duke autorizuar persona të tjerë të bëjë të mundur regjistrimin e këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në çdo institucion tjetër ku një regjistrimi është i kërkuar me ligj.

ASAMBLEË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

AGROCON ALBANIA SH.P.K.

ORTAKU I VETËM

UNITED ELECTRONIC DISTRIBUTION FZE

Përfaqësuar nga Drejtori

Z. Altin Daka

UNITED ELECTRONIC DISTRIBUTION
P.O. Box 17661, Dubai